

REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1021/1... Prot.

Tiranë, më 24.07.2017

Vendim
Nr. 22, datë 24.07.2017

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIN NR. 19, DATË 14.07.2017 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT ADMINISTRATIV NË VENDET E LIRA TË PUNËS NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE"

Bazuar në nenin 49/f të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 24.07.2017

KONSTATON SE:

Pranë Bordit të Administrimit është paraqitur shkresa me nr. 1010/4 Prot, datë 20/07/2017 e Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë nëpërmjet të cilës kërkohet plotësimi i vendimit nr 19, datë 14.07.2017 të Bordit të Administrimit nëpërmjet të cilit janë përcaktuar kriteret dhe procedurat për vendet e lira për personelin administrativ në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Në këtë shkresë parashtrohet se procedura e përcaktuar në vendimin nr. 19, datë 14.07.2017 është e paplotë pasi nuk ka parashikuar ngritjen e komisionit *ad-hoc* të vlerësimit të dosjeve, komisionit të intervistës si dhe afatet e ankimimit. Përsa më sipër, Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë kërkon që vendimi nr. 19, datë 14.07.2017 i Bordit të Administrimit të plotësohet me këtë procedurë.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, Bordi i Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbledhjen e datës 24.07.2017


VENDOSI:

1. Plotësimin e vendimit nr. 19, datë 14.07.2017 përsa i përket procedurës që duhet të ndiqet si më poshtë:
 - Pas njoftimit të procedurës së punësimit, Rektori urdhëron ngritjen e komisionit *ad-hoc* pranë rektoratit për përzgjedhjen e personelit administrativ. Komisioni

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Faqe 1 nga 3



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

do të kryesohet nga Administratori, Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit si dhe nga Drejtori i drejtorisë përkatëse ku do të punësohet aplikanti.

- Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, por jo më vonë se 2 (dy) ditë, Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit, mer në dorëzim gjithë dosjet e kandidatëve dhe i a përcjell komisionit listën e kandidatëve me dokumentacionin përkatës.
- Skema e vlerësimit hartohet me vendim të Komisionit ad-hoc dhe miratohet nga Rektori.
- Vlerësimi i mësipërm kryhet nga çdo anëtar i Komisionit ad-hoc për secilin kandidat. Në përfundim, mblidhen pikët e dhëna nga anëtarët e Komisionit për të njëjtin kandidat dhe hartohet klasifikimi paraprak.
- Pas vlerësimit paraprak kryhet intervista me kandidatët e klasifikuar, të cilët njoftohen në numrin personal të telefonit të deklaruar dhe adresën e-mail-it të deklaruar prej tyre, nga Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.
- Komisioni ad-hoc vëzhgon dhe vlerëson performancën e komunikimit dhe njohuritë e kandidatëve sipas kriterëve përkatëse të vendit të punës të kandidatëve dhe i vlerëson ata me pikë, sipas sistemit të pikëzimit .
- Komisioni ad-hoc plotësojnë pasqyrën përmbledhëse të rezultateve të konkurimit në të dy fazat dhe së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës ia përcjellin Rektorit.
- Sektori i Burimeve Njerëzore bën njoftimin e kandidatëve fitues dhe atyre që nuk përzgjidhen (jo fitues).
- Kandidatët jo fitues kanë të drejtën e ankimit tek Rektori brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit të komisionit.

2. Të ndryshojë afatin e aplikimit si më poshtë:

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentave është 14 ditë, nga dita e publikimit të njoftimit në Web-site të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë dhe A.P.P, Tiranë.

3. Të gjitha dispozitat e përcaktuara në vendimin nr. 19, datë 14.07.2017 që bien në kundërshtim me procedurën dhe afatin e mësipërm shfuqizohen.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

5. Ngarkohet Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentit Zyrtar të bëjë shpalljen për konkurim të hapur për pozicionet e mësipërme në web-site e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, dhe APP.

1. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Marinela Muço – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar
4. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Elsajed Rexhaj – anëtar

SEKREIARI:

OLSI VAMBEÇI

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.